

VENDIM
Nr.380, datë 8.4.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS LOPËZ TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Lopëz të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Lopëz të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.38, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Lopëz të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Lopëz për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NUMRAT RENDORË TË PRONAVE NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
1-9	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE.	NË PRONËSI
10-12	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN SHËNDETIT PUBLIK.	NË PRONËSI
14-20	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE SOCIAL-KULTURORE E SPORTIVE.	NË PRONËSI
21-38	VARREZAT PUBLIKE	NË PRONËSI
39-40	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE ADMINISTRATIVE	NË PRONËSI
41-168	TROJE TË LIRA DHE HAPËSIRA PUBLIKE TË PAZËNA NDËRMJET NDËRTESAVE OSE OBJEKTEVE TË ÇDO LLOJI.	NË PËRDORIM
169-172,174-176,178-180, 182-184, 186-188	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE)	NË PËRDORIM
173,177,181,185,189 278,279,285,286 (VETËM KANALET E TRETA)	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA JOPRODUKTIVE DHE KANALET TË TRETA)	NË PRONËSI
311-462	INFRASTRUKTURË (RRUGË VENDORE)	NË PRONËSI
463-475	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E UJËSJELLËS-KANALIZIME	NË PRONËSI